

<http://www.weprotect.org/>

## INTERNET I SIGURT PËR FËMIJËT NË SHQIPËRI

### 1. Çfarë është #WePROTECT

#WePROTECT është një nismë e Mbretërisë së Bashkuar dhe UNICEF, që ka qëllim të mbështesë në rang botëror nismat për mbrojtjen dhe trajtimin e fëmijëve nga abuzimi dhe shfrytëzimi online. Kjo nismë synon që të identifikojë dhe mbrojë viktimat e abuzimit seksual, të fshijë materialet e abuzimit seksual të fëmijëve në internet, të forcojë bashkëpunimin e shteteve për kapjen e abuzuesve, si dhe të ndërtojë kapacitetet e nevojshme për trajtimin e abuzimit seksual të fëmijëve.

#WePROTECT ka bashkuar zyrtarët më të lartë të qeverive nga më shumë se 50 vende të ndryshme, përfaqësues të interpolit, sektorin privat, agjensitë ndërkombëtare dhe organizatat kyçe të shoqërisë civile, linjat e telefonit për fëmijë, të cilat kanë renë dakort të ndërmarrin një seri masash për ti dhënë fund shfrytëzimit seksual të fëmijëve në internet. Ata nënshkruan së bashku tre marrëveshje ndërveprimi: për qeveritë, për bizneset dhe për organizatat gjate Samitit të Londrës (2014) dhe atij të ABU Dhabit (2015).

Qeveria Shqipëtare ka qënë pjesë e marrëveshjes për qeveritë e nënshkruar në Samitin e Abu Dhabit për të parandaluar dhe trajtuar rastet e abuzimit dhe shfrytëzimit online, në nëntor të vitit 2015. ([https://www.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment\\_data/file/484757/FINAL\\_Country\\_SOA\\_111215.pdf](https://www.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment_data/file/484757/FINAL_Country_SOA_111215.pdf)). E quajtur “Deklarata e veprimeve të Qeverive për të adresuar shfrytëzimit seksual të fëmijëve në internet” inkurajon shtetet të ndjekin, “Modelin Kombëtar” ([https://www.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment\\_data/file/477580/WePROTECT\\_-\\_Model\\_National\\_Response\\_2\\_.pdf](https://www.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment_data/file/477580/WePROTECT_-_Model_National_Response_2_.pdf)) i cili përshkruan praktikat më të mira të vendeve për t’u ndërmarrë kur zhvillohen strategjitë për të luftuar shfrytëzimin seksual të fëmijëve. Ai identifikon kapacitetet kyçe të nevojshme për të parandaluar rrezikun, ndjekur shkelësit, mbështetur viktimat, si dhe për të përgatitur ndërhyrjet si pjesë e përgjigjes gjithëpërfshirëse.

### 2. Shqipëria dhe #WePROTECT

Në mbështetje të nismës #WePROTECT, UNICEF Shqipëri në bashkëpunim me MMSR, ASHMDF, MB, MAS, MAPI, në partneritet me CRCA, Linja e Telefonit për Fëmijë – ALO 116 dhe industrinë janë duke punuar për të koordinuar përpjekjet e institucioneve publike, ofruesve të internetit, OSHC-ve, mësuesve dhe prindërve, policisë, shërbimeve për fëmijët, si sektorit privat në funksion të mbrojtjes së fëmijëve online.

Në nivel kombëtar kjo nismë synon që të ndërtojë infrastrukturën e nevojshme; për të identifikuar viktimat e abuzimit dhe për të përdorur praktikat më të mira të trajtimit të viktimave; për të ngritur strategji që sigurojnë bashkëpunimin e të gjithë aktorëve socialë në parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijëve në Shqipëri nga abuzimi dhe shfrytëzimi online; për forcimin e legjislacionit që mundëson trajtimin e këtij krimi ligjërish, kapjen e abuzuesve dhe ndërton mekanizma të mirëfilltë parandalimi dhe trajtimi të viktimave; për t’u siguruar që çdo aktor social ka të drejtën dhe detyrimin për të raportuar rastet e abuzimit dhe materialet me përmbajtje të papërshtatshme për fëmijët.

<http://www.weprotect.org/>

*Programi dhe Plani i Punës përfshin hapa specifike që konsistojnë në:*

- Përmirësimin e mekanizmave të raportimit nëpërmejt Linjës së Telefonit për Fëmijë ALO 116 , Platformës Kombëtare të Informacionit për Sigurinë në Internet, aplikacioneve në telefon etj;
- Specializimin e punonjësve të fushës, nëpërmjet manualeve dhe trajnimeve të vazhdueshme, duke përfshirë këtu: policinë për kapacitetet investiguese dhe parandaluese, mësuesit për çështjet e informimit dhe psiko-edukimit, punonjësit e njësive për mbrojtjen e fëmijëve për çështjet e trajtimit dhe menaxhimit të rasteve të shfrytëzimit dhe abuzimit online etj;
- Mundësimin dhe qasjen e mënyrave, mjeteve për informimin e fëmijëve mbi abuzimin online, mbrojtjen dhe raportimin e krimeve. Kjo gjë do të mundësohet nëpërmjet fushatave ndërgjegjësuese.
- Forcimit të bashkëpunimit me sektorin privat

### **3. Aktivitete specifike:**

- Është shumë i rëndësishëm forcimi i dialogut midis institucioneve shtetërore, shoqërisë civile dhe agjensive private për sigurinë në internet, me synim krijimin e një rrjeti informal midis të gjithë aktorëve që punojnë dhe kujdesen për të drejtat e fëmijëve. Nisur nga kjo, hapat e metejshëm janë në proces:
- Formalizimi i marrëdhënies së bashkëpunimit për internetin e sigurt midis katër ministri kryesore (MoU)
- Formimi i grupit konsultues me pjesëmarrje të katër ministrave të sipërpermendura, OSHC, ALCIRT, ASHMDF, IZHA, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, AKEP, kompanitë telefonike, ISP-të, Europoli, policia.
- Formimi i një grupi ekspertësh për hartimin e planit të veprimeve në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve online
- Promovimi i platformës së informimit (për mësuesit, prinderit, fëmijet, punonjësit e mbrojtjes së fëmijëve, policinë) dhe raportimit të rasteve të abuzimit online: <http://www.isigurt.al/> (është ende draft)
- Promovimi i aplikacionit celular: iSigurt
- Hartimi i manualeve për policinë, mësuesit dhe PMF në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve online.
- Fushata ndërgjegjësuese për sigurinë e fëmijëve online. Kjo fushata do të ketë disa elemente të cilët janë duke u hartuar. Një prej elementeve lidhet me ndërgjegjësimin në shkollë, ku 10 grupe rinore në 10 qytete janë trajnuar në lidhje me sigurinë në internet dhe se shpjegimi do të fillojë me orët ndërgjegjësuese në shkollë me fëmijë, mësues dhe prinder. Grupet rinore mbështeten dhe koordinohen nga një organizatë lokale. Kjo organizatë ka informuar bashkinë, Zyren Arsimore dhe aktorët e tjerë sociale të qytetit përkatës mbi nismën.